LIGJ
Nr. 69/2022

PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES ME SHKËMBIM NOTASH NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË JAPONISË MBI BASHKËPUNIMIN EKONOMIK JAPONEZ PËR PROJEKTIN PËR PËRMIRËSIMIN E PAJISJEVE PËR KONSERVIMIN, RESTAURIMIN DHE MJEDISIN EKSPOZUES NË MUZEUN HISTORIK KOMBËTAR TË SHQIPËRISË

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja me shkëmbim notash ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Japonisë mbi bashkëpunimin ekonomik japonez për projektin për përmirësimin e pajisjeve për konservimin, restaurimin dhe mjedisin ekspozues në Muzeun Historik Kombëtar të Shqipërisë, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 6.10.2022.

Shpallur me dekretin nr.13861, datë 17.10.2022, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.

AMBASADA JAPONEZE

Tiranë, 7 qershor 2022

Shkëlqesi,

Kam nderin t'u referohem diskutimeve të fundit të zhvilluara ndërmjet përfaqësuesve të Qeverisë së Japonisë dhe të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë (në vijim i referuar si "Përfituesi"), në lidhje me bashkëpunimin ekonomik japonez, që do të zgjerohet me synim nxitjen e zhvillimit ekonomik dhe social të Republikës së Shqipërisë, duke përfshirë edhe promovimin kulturor. Më tej kam nderin të propozoj në emër të Qeverisë së Japonisë mirëkuptimin e mëposhtëm:

1. 1)Me qëllim dhënien e kontributit në zbatimin e Projektit për Përmirësimin e Pajisjeve për Ruajtjen, Restaurimin dhe Mjedisin për Ekspozim në Muzeun Historik Kombëtar të Shqipërisë (në vijim i referuar si "Projekti") nga Përfituesi, Qeveria e Japonisë ka vendosur që një grant deri në njëqind e dyzet e pesë milionë e treqind mijë jen japonezë (145,300,000 ¥) (në vijim i referuar si "Granti") do t'i alokohet Përfituesit, sipas legjislacionit dhe përcaktimeve buxhetore të Japonisë.

2) Granti do të vihet në dispozicion, me lidhjen e një marrëveshje granti ndërmjet Përfituesit ose autoritetit të tij të caktuar dhe Agjencisë Japoneze të Bashkëpunimit Ndërkombëtar (JICA) (në vijim i referuar si "G/A").

3) Termat dhe kushtet e Grantit, si dhe procedurat mbi përdorimin e tij do të rregullohen nga G/A, brenda fushëveprimit të këtij mirëkuptimi.

2. Granti do të jetë i disponueshëm gjatë periudhës së përcaktuar, siç mund të jetë specifikuar në G/A, me kusht që kjo periudhë të jetë ndërmjet datës së hyrjes në fuqi të G/A dhe periudhës 30 prill 2026. Periudha mund të zgjatet me pëlqimin e ndërsjellë ndërmjet autoriteteve përkatëse të Qeverisë së Japonisë dhe Përfituesit.

3. Granti do të përdoret nga Përfituesi në mënyrën e duhur dhe ekskluzivisht për blerjen e produkteve dhe/ose shërbimeve të tilla, të cilat janë të nevojshme për zbatimin e Projektit, siç mund të specifikohet në G/A (në vijim të referuara si "Produktet" dhe "Shërbimet").

H.E. znj. Elva Margariti
MINISTRE E KULTURËS E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

4. Përfituesi ose autoriteti i caktuar do të lidhin kontrata në jen japonezë me shtetas japonezë, për blerjen e Produkteve dhe/ose Shërbimeve (Termi "shtetas japonezë" në këtë mirëkuptim nënkupton persona fizikë ose juridikë japonezë të kontrolluar nga persona fizikë japonezë dhe të regjistruar në Japoni). Kontrata të tilla do të verifikohen nga JICA për të qenë të pranueshme për Grantin.

5. Granti do të zbatohet nga JICA, në përputhje me dispozitat e G/A-së, duke kryer pagesa në jen japonez në një llogari që do të hapet në emër të Përfituesit, në një bankë në Japoni të caktuar nga Përfituesi ose autoriteti i caktuar.

6. 1) Përfituesi duhet të marrë masat e nevojshme, që:

a) të garantojë që detyrimet doganore, taksat e brendshme dhe taksat e tjera fiskale, të cilat mund të vendosen në vendin e Përfituesit lidhur me blerjen e Produkteve dhe/ose Shërbimeve, janë të përjashtuara ose do të mbulohen nga autoriteti i tij i caktuar pa përdorur Grantin;

b) të marrë në konsideratë ndikimin mjedisor dhe atë social në zbatimin e projektit;

c) të garantojë që Produktet dhe/ose Shërbimet të mirëmbahen dhe përdoren në mënyrë efektive për zbatimin e Projektit;

d) të ofrojë lehtësira për shpërndarjen e energjisë elektrike, furnizimit me ujë dhe drenazhimit dhe lehtësirave të tjera, të cilat mund të çmohen të nevojshme për zbatimin e Projektit jashtë vendpunimit/eve;

e) të garantojë shkarkimin e shpejtë, zhdoganimin dhe transportin e brendshëm në shtetin e Përfituesit të Produkteve;

f) të ofrojë lehtësira për persona fizikë japonezë dhe/ose personave fizikë të vendeve të treta, shërbimet e të cilëve mund të kërkohen lidhur me furnizimin e Produkteve dhe/ose Shërbimeve, të cilat mund të jenë të nevojshme për hyrjen dhe qëndrimin e tyre në vendin Përfitues, për kryerjen e punës së tyre;

g) të garantojë sigurinë e personave të angazhuar në zbatimin e Projektit në vendin e Përfituesit; dhe

h) të mbulojë të gjitha shpenzimet e nevojshme për zbatimin e Projektit, përveç atyre që mbulohen nga Granti.

2) Me kërkesë, Përfituesi do t'i japë Qeverisë së Japonisë informacionin e nevojshëm për projektin.

3) Në lidhje me transportin dhe siguracionin detar të Produkteve, Përfituesi do të ndalojë vendosjen e çdo kufizimi që mund të pengojë konkurrencën e drejtë dhe të lirë midis shoqërive të sigurimit të transportit detar.

4) Produktet dhe/ose Shërbimet nuk do të eksportohen ose rieksportohen nga vendi i Përfituesit.

7. Qeveria e Japonisë dhe Përfituesi do të konsultohen me njëri-tjetrin, në lidhje me çdo çështje që mund të lindë nga/ose në lidhje me këtë mirëkuptim.

Më tej, kam nderin të propozoj që kjo Notë dhe Nota e Shkëlqesisë Suaj në përgjigje, duke konfirmuar në emër të Përfituesit mirëkuptimin e mësipërm, do të përbëjë një marrëveshje ndërmjet dy qeverive, e cila do të hyjë në fuqi në datën e marrjes nga Qeveria e Japonisë së njoftimit me shkrim të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për përfundimin e procedurave të brendshme të nevojshme për hyrjen në fuqi të kësaj marrëveshjeje.

Përfitoj nga kjo mundësi për t'i shprehur Shkëlqesisë Suaj konsideratat e mia më të larta.

Tadaka Mitsuyuki
AMBASADOR I JASHTËZAKONSHËM DHE
FUQIPLOTË I JAPONISË NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Tiranë, 7 qershor 2022

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

Tiranë, 7 qershor 2022

Shkëlqesi,

Kam nderin të konfirmoj marrjen e Notës së datës së sotme të Shkëlqesisë Suaj, e cila vijon si më poshtë:

"Kam nderin t'u referohem diskutimeve të fundit të zhvilluara ndërmjet përfaqësuesve të Qeverisë së Japonisë dhe të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë (në vijim i referuar si "Përfituesi"), në lidhje me bashkëpunimin ekonomik japonez që do të zgjerohet, me synim, nxitjen e zhvillimit ekonomik dhe social të Republikës së Shqipërisë, duke përfshirë edhe promovimin kulturor. Më tej kam nderin të propozoj në emër të Qeverisë së Japonisë mirëkuptimin e mëposhtëm:

1. 1) Me qëllim dhënien e kontributit në zbatimin e Projektit për Përmirësimin e Pajisjeve për Ruajtjen, Restaurimin dhe Mjedisin për Ekspozim në Muzeun Historik Kombëtar të Shqipërisë (në vijim i referuar si "Projekti") nga Përfituesi, Qeveria e Japonisë ka vendosur që një grant deri në njëqind e dyzet e pesë milionë e treqind mijë jen japonezë (145,300,000 ¥) (në vijim i referuar si "Granti") do t'i alokohet Përfituesit, sipas legjislacionit dhe përcaktimeve buxhetore të Japonisë.

2) Granti do të vihet në dispozicion me lidhjen e një marrëveshjeje granti ndërmjet Përfituesit ose autoritetit të tij të caktuar dhe Agjencisë Japoneze të Bashkëpunimit Ndërkombëtar (JICA) (në vijim i referuar si "G/A").

3) Termat dhe kushtet e Grantit, si dhe procedurat mbi përdorimin e tij do të rregullohen nga G/A brenda fushëveprimit të këtij mirëkuptimi.

2. Granti do të jetë i disponueshëm gjatë periudhës së përcaktuar, siç mund të jetë specifikuar në G/A, me kusht që kjo periudhë të jetë ndërmjet datës së hyrjes në fuqi të G/A dhe periudhës 30 prill 2026. Periudha mund të zgjatet me pëlqimin e ndërsjellë ndërmjet autoriteteve përkatëse të Qeverisë së Japonisë dhe Përfituesit..

3. Granti do të përdoret nga Përfituesi në mënyrën e duhur dhe ekskluzivisht për blerjen e produkteve dhe/ose shërbimeve të tilla, të cilat janë të nevojshme për zbatimin e Projektit, siç mund të specifikohet në G/A (në vijim të referuara si "Produktet" dhe "Shërbimet").

Shkëlqesia e Tij, z. Tadaka Mitsuyuki
AMBASADOR I JASHTËZAKONSHËM DHE FUQIPLOTË
I JAPONISË NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

4. Përfituesi ose autoriteti i caktuar do të lidhin kontrata në jen japonezë me shtetas japonezë, për blerjen e Produkteve dhe/ose Shërbimeve (termi "shtetas japonezë", në këtë mirëkuptim nënkupton persona fizikë ose juridikë japonezë të kontrolluar nga persona fizikë japonezë dhe të regjistruar në Japoni.). Kontrata të tilla do të verifikohen nga JICA për të qenë të pranueshme për Grantin.

5. Granti do të zbatohet nga JICA, në përputhje me dispozitat e G/A, duke kryer pagesa në jen japonezë në një llogari që do të hapet në emër të Përfituesit, në një bankë në Japoni të caktuar nga Përfituesi ose autoriteti i caktuar.

6. 1) Përfituesi duhet të marrë masat e nevojshme, që:

a) të garantojë që detyrimet doganore, taksat e brendshme dhe taksat e tjera fiskale, të cilat mund të vendosen në vendin e Përfituesit, lidhur me blerjen e produkteve dhe/ose shërbimeve, janë të përjashtuara ose do të mbulohen nga autoriteti i tij i caktuar pa përdorur Grantin;

b) të marrë në konsideratë ndikimin mjedisor dhe social në zbatimin e projektit;

c) të garantojë që Produktet dhe/ose Shërbimet të mirëmbahen dhe përdoren në mënyrë efektive për zbatimin e Projektit;

d) të ofrojë lehtësira për shpërndarjen e energjisë elektrike, furnizimit me ujë dhe drenazhimit dhe lehtësirave të tjera, të cilat mund të çmohen të nevojshme për zbatimin e Projektit jashtë vendpunimit/eve;

e) të garantojë shkarkimin e shpejtë, zhdoganimin dhe transportin e brendshëm në shtetin e Përfituesit të Produkteve;

f) të ofrojë lehtësira për persona fizikë japonezë dhe/ose persona fizikë të vendeve të treta, shërbimet e të cilëve mund të kërkohen lidhur me furnizimin e Produkteve dhe/ose Shërbimeve, të cilat mund të jenë të nevojshme për hyrjen dhe qëndrimin e tyre në vendin Përfitues, për kryerjen e punës së tyre;

g) të garantojë sigurinë e personave të angazhuar në zbatimin e Projektit në vendin e Përfituesit; dhe

h) të mbulojë të gjitha shpenzimet e nevojshme për zbatimin e Projektit, përveç atyre që mbulohen nga Granti.

2) Me kërkesë, Përfituesi do t'i japë Qeverisë së Japonisë informacionin e nevojshëm për projektin.

3) Në lidhje me transportin dhe siguracionin detar të Produkteve, Përfituesi do të ndalojë vendosjen e çdo kufizimi që mund të pengojë konkurrencën e drejtë dhe të lirë midis shoqërive të sigurimit të transportit detar.

4) Produktet dhe/ose Shërbimet nuk do të eksportohen ose rieksportohen nga vendi i Përfituesit.

7. Qeveria e Japonisë dhe Përfituesi do të konsultohen me njëra-tjetrën, në lidhje me çdo çështje që mund të lindë nga/ose në lidhje me këtë mirëkuptim.

Më tej kam nderin të propozoj që kjo Notë dhe Nota e Shkëlqesisë Suaj në përgjigje, duke konfirmuar në emër të Përfituesit mirëkuptimin e mësipërm, do të përbëjë një marrëveshje ndërmjet dy Qeverive, e cila do të hyjë në fuqi në datën e marrjes nga Qeveria e Japonisë së njoftimit me shkrim të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për përfundimin e procedurave të brendshme të nevojshme për hyrjen në fuqi të kësaj marrëveshjeje.".

Më tej kam nderin të konfirmoj në emër të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë mirëkuptimin e mësipërm dhe të bie dakord që Nota e Shkëlqesisë Suaj në përgjigje do të përbëjë një marrëveshje ndërmjet dy qeverive, e cila do të hyjë në fuqi në datën e marrjes nga Qeveria Japoneze të njoftimit me shkrim nga Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë të plotësimit të procedurave të nevojshme të brendshme për hyrjen në fuqi të kësaj marrëveshjeje.

Përfitoj nga kjo mundësi për t'i shprehur Shkëlqesisë Suaj konsideratat e mia më të larta.

Elva Margariti
MINISTRE E KULTURËS E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

PROCESVERBALI I DISKUTIMEVE

Duke iu referuar shkëmbimit të Notave ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë (në vijim i referuar si "Përfituesi") dhe Qeverisë së Japonisë, datë 7 qershor 2022, në lidhje me bashkëpunimin ekonomik japonez, që do të zgjerohet me synimin për të nxitur zhvillimin ekonomik dhe social të Republikës së Shqipërisë (në vijim i referuar si "Shkëmbimi i Notave"), përfaqësuesit e Delegacionit japonez dhe të Delegacionit shqiptar kërkojnë të vijojnë, si më poshtë:

1. Në lidhje me paragrafin 3 të Shkëmbimit të Notave, përfaqësuesi i delegacionit japonez deklaroi se Qeveria e Japonisë e kupton se Përfituesi do të marrë masat e nevojshme për të parandaluar çdo ofertë, dhuratë ose pagesë, kompensim ose përfitim që do të interpretohej si një praktikë korruptive në vendin e Përfituesit që bëhet si një nxitje ose shpërblim për dhënien e kontratave të përmendura në paragrafin 4 të Shkëmbimit të Notave.

2. Në lidhje me nënparagrafin 2 të paragrafit 6 të Shkëmbimit të Notave, përfaqësuesi i Delegacionit Japonez deklaroi se Qeveria e Japonisë kupton, se:

a) Informacioni i nevojshëm përfshin informacion mbi praktikën korruptive, në lidhje me projektin për përmirësimin e pajisjeve për ruajtjen, restaurimin dhe mjedisin ekspozues në Muzeun

Historik Kombëtar të Shqipërisë, referuar në nënparagrafin 1 të paragrafit 1 të Shkëmbimit të Notave; dhe

b) Marrësi do të sigurojë trajtim të drejtë të burimeve të këtij informacioni.

3. Përfaqësuesi i Delegacionit shqiptar deklaroi se delegacioni shqiptar nuk ka asnjë kundërshtim ndaj deklaratës së përfaqësuesit të delegacionit japonez të përmendur më sipër.

Tiranë, 7 qershor, 2022

Elva Margariti
MINISTRE E KULTURËS
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Takada Mitsuyuki
AMBASADOR I JASHTËZAKONSHËM
DHE FUQIPLOTË I JAPONISË NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

PROCESVERBALI I DISKUTIMEVE

Duke iu referuar shkëmbimit të notave ndërmjet Qeverisë së Japonisë dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë (në vijim i referuar si "Përfituesi"), datë 7 qershor 2022, në lidhje me bashkëpunimin ekonomik japonez që do të zgjerohet me synimin për të nxitur zhvillimin ekonomik dhe social të Republikës së Shqipërisë (në vijim i referuar si "Shkëmbimi i Notave"), përfaqësuesit e delegacionit japonez dhe të delegacionit shqiptar kërkojnë të vijojnë, si më poshtë:

1. Në lidhje me paragrafin 3 të Shkëmbimit të Notave, përfaqësuesi i delegacionit japonez deklaroi se Qeveria e Japonisë e kupton se Përfituesi do të marrë masat e nevojshme për të parandaluar çdo ofertë, dhuratë ose pagesë, kompensim ose përfitim që do të interpretohej si një praktikë korruptive në vendin e Përfituesit, që bëhet si një nxitje ose shpërblim për dhënien e kontratave të përmendura në paragrafin 4 të Shkëmbimit të Notave.

2. Në lidhje me nënparagrafin 2 të paragrafit 6 të Shkëmbimit të Notave, përfaqësuesi i delegacionit japonez deklaroi se Qeveria e Japonisë kupton, se:

a) Informacioni i nevojshëm përfshin informacion mbi praktikën korruptive, në lidhje me projektin për përmirësimin e pajisjeve për ruajtjen, restaurimin dhe mjedisin ekspozues në Muzeun Historik Kombëtar të Shqipërisë, referuar në nënparagrafin 1 të paragrafit 1 të Shkëmbimit të Notave; dhe

b) Marrësi do të sigurojë trajtim të drejtë të burimeve të këtij informacioni.

3. Përfaqësuesi i delegacionit shqiptar deklaroi se delegacioni shqiptar nuk ka asnjë kundërshtim ndaj deklaratës së përfaqësuesit të delegacionit japonez të përmendur më sipër.

Tiranë, 7 qershor 2022

Takada Mitsuyuki
AMBASADOR I JASHTËZAKONSHËM
DHE FUQIPLOTË I JAPONISË NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Elva Margariti
MINISTRE E KULTURËS
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË